STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 25 shkurt 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON PROGRAMIN E NDERMJETESIMIT TE DFS PER KERKESAT E KUNDERSHTUARA OSE TE MOHUARA PER PRONARET E SHTEPIVE NE LIDHJE ME STUHINE SENDI (SANDY)

Ndërmjetësimi i vullnetshëm ofron zgjidhje të shpejtë kur siguruesit dhe pronarët e shtëpive nuk mund të bien dakort

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Governor Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) ka krijuar një proces të ndëmjetësimit vullnetar për pronarët e shtëpive që kanë mosmarrëveshje në lidhje me kërkesat e tyre të sigurimit ose janë të pakënaqur me mohimin e kërkesave të tyre që vijnë nga stuhia Sendi (Sandy).

"Ndërmjetësimi ofron një zgjidhje të shpejtë, me kosto të ulët të kërkesave të sigurimit për pronarët e shtëpive që nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje me ndërmarrjet e tyre të sigurimit të pronarëve të shtëpive mbi kërkesat nga stuhia Sendi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Eshtë gjithashtu shumë më pak i shtrenjtë për siguruesit sesa procesi ligjor, kështu që është një fitore për këdo."

Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare (Superintendent of Financial Services) Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), tha, "Shumica e kërkesave të sigurimit jo të përmbytjes janë zgjidhur tashmë nga ndërmarrjet e sigurimit. Por e dimë nga stuhi të së kaluarës se disa kërkesa janë të vështira për t'u zgjidhur. E dimë gjithashtu se pas disa stuhive të tjera të mëdha, ndërmjetësimi ishte jashtëzakonisht i suksesshëm në shtete të tjera. Kështu që Departamenti i Shërbimeve Financiare (Department of Financial Services) ka nxjerrë një rregullore urgjente që drejton siguruesit të ofrojnë dhe të paguajnë për ndërmjetësimin vullnetar për kërkesat e sigurimit pezull dhe të mohuara nga stuhia Sendi (Sandy)."

Shumica e kërkesave të sigurimit jo të përmbytjes janë zgjidhur tashmë dhe shumica e atyre të pazgjidhura janë ende në vazhdim. Deri më 8 shkurt, siguruesit që përfaqësonin 90 përqind të tregut në zonat e prekura nga Sendi (Sandy) njoftuan pranë Departamentit se, në lidhje me të gjitha kërkesat përveç përmbytjes, kanë marë 432,000 kërkesa dhe kanë zgjidhur plotësisht 87 përqind. Këta sigurues kanë paguar 3.6 miliardë dollarë nga 4.6 miliardë dollarë që presin të paguajnë. Në lidhje me sigurimin e pronave të banimit, ka patur 287,000 kërkesa dhe 94 përqind janë zgjidhur plotësisht, me siguruesit që paguan 1.5 miliardë dollarë nga 1.7 miliardë dollarë që presin të paguajnë.

Sipas rregullores së re, pronarët e shtëpive mund të kërkojnë ndërmjetësim për kërkesat që janë kundërshtuar ose nëse nuk janë dakort me mohimin nga ndërmarrja e sigurimit të një kërkese.

Pas uraganeve Endrju (Andrew), Katrina dhe Rita, Florida, Misisipi (Mississippi) dhe Luiziana (Louisiana) krijuan programe të ndërmjetësimit jo të detyrueshme, të administruara nga Shoqata Amerikane e Arbitrimit (American Arbitration Association), që synuan të sillnin zgjidhjen e shpejtë të kërkesave të kundërshtuara të sigurimit.

Si konsumatorët, ashtu edhe siguruesit e kanë gjetur programin të dobishëm. Pas uraganit Endrju (Andrew), një program i financuar nga Departamenti i Sigurimit i Floridës (Florida Department of Insurance) trajtoi 2,400 kërkesa dhe arriti një nivel zgjidhje prej 92 përqind. Në Luiziana (Louisiana), 15,000 u paraqitën pas Katrinës (Katrina), me një nivel zgjidhje prej 74 përqind. Në Misisipi (Mississippi), 5,000 raste sollën zgjidhje në 82 përqind të kohës.

Ndryshimi urgjent në Rregulloren 64 krijon një program të ngjashëm ndërmjetësimi në Nju Jork (New York), që do të administrohet nga AAA, sipas procedurave dhe standarteve të miratuara nga Departamenti.

Programi do të trajtojë kërkesat e kundërshtuara të pronave të paluajtshme dhe personale, përveç atyre në lidhje me dëmin ndaj automjeteve, që u paraqitën ndërmjet 26 tetorit 2012 dhe 15 nëntorit 2012 në qarqet e Bronx (Bronksit), Kings (Kings), Nassau (Naso), Nju Jork (New York), Oranzh (Orange), Kuins (Queens), Riçmond (Richmond), Roklënd (Rockland), Safolk (Suffolk) ose Uestçestër (Westchester). Kërkesat e bëra sipas Programit Kombëtar të Sigurimit ndaj Përmbytjes (National Flood Insurance Program), që administrohet nga qeveria federale, nuk kualifikohen.

Ndryshimi urgjent detyron siguruesit që të njoftojnë pronarët e shtëpive të tyre për të drejtën për të ndërmjetësuar kërkesat që kualifikohen. Siguruesit do të duhet të marrin pjesë në ndërmjetësime me mirëbesim dhe të paguajnë për kostot e AAA.

Ndërmjetësimi nuk është i detyrueshëm për pronarin e shtëpisë dhe nuk do të prekë të drejtat e tjera ligjore të pronarit të shtëpisë, si e drejta për të kërkuar një vlerësimin, e drejta për të paraqitur një padi civile dhe çdo të drejtë tjetër që sigurohet nga ligji.

Ndërmjetësimi mund të zhvillohen personalisht, nëpërmjet një konference me video ose konferencës me telefon, në varësi të asaj që biet dakort ndërmjet siguruesit dhe pronarit të shtëpisë.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418